

RELACION TEKNIK

PËR OBJEKTIN: VAZHDIM MEREMETIM KANALI DHE BLERJE TUB SIFONI DEGËZIMI BËRSNIK MASHAN NJ. A. KODOVJAT BASHKIA GRAMSH

Kanali vaditës Posnovisht-Bërsnik-Kodovjat-Mashan, merr ujë nga rezervuari Posnovisht dhe ndahet në dy degëzime në dalje të fshatit Bërsnik Sipër, nga ku njeri shkon në drejtim të fshatit Mashan ndërsa tjetri shkon për në fshatrat Bersnik Poshtë e Kodovjat.

Në degëzimin Bërsnik-Mashan që është pjesë e veprës ujitese nga rezervuarët Posnovisht ndërtuar në vitet '70 me gjatësi rreth 4 km ndodhen tre sifone me tuba celiku Ø400 me gjatësi rreth 1.4 km të ndërtuar në terrene mjaft të thyera dhe aktualisht janë tepër të amortizuar e të dëmtuar me carje e rrjedhje uji në mjaft vende.

Që nga koha e ndertimit, këtij objekti nuk i është bërë rikonstruksion i plotë dhe aktualisht paraqitet tepër i amortizuar si në tubacionet e celikut po ashtu ka edhe mjaft dëmtime në veshjet me beton në kanalet e hapur.

Aktualisht tubacioni i celikut nëpër sifone ka rrjedhje të ujit prej carjeve gjatesore apo të shkeputjeve të pareteve prej presionit të ujit të krijuara nga amortizimi prej ndryshkut dhe kanë shkaktuar gërryerje e rreshqitje dherash nga kanali në trasenë e tubacionit në shumë vende si dhe ndarje të tubacioneve në tegelat e saldimeve si pasoje e spostimit të tij nga pozicioni fillestar.

Më të shumta dhe më të shpeshta janë dëmtimet e tubacionit me rrjedhje të konsiderueshme uji në pjesën e sifonit të madh me gjatësi prej rreth 890ml, i cili ndodhet në fillim të degëzimit për në fshatin Mashan, duke ndërprerë vaditjen normale të tokave në keto zona.

Gjithashtu kanali në përgjithësi ka plasaritje e carje të veshjes prej betoni apo nëpër priza si dhe mbushje me aluvione të sjella nga rrëket e ujit që krijohen nga rreshjet si dhe bllokime nga barishtet e shkurret e rritura na skarpatet anash kanalit.

Në këto rrethana ky objekt nuk plotëson kushtet për dërgimin e sasisë së plotë të ujit të nevojshem për vaditjen e tokave në Ekonomitë bujqësore të fermerëve në fshatrat Bërsnik, Mashan e Kodovjat në rreth 580 ha toka bujqësore nën ujë.

Për vënien në funksionim të këtij segmenti është e nevojshme të ndërhyhet për eliminimin e rrjedhjeve në carjet e tubave nëpërmjet saldimit të pllakave prej celiku apo zëvendësim tubacioni atje ku ata janë të amortizuar në të gjithë gjatësinë ku riparimet me saldime me copa nuk mund të realizohen.

Kështu për shkak të mungesës së financimit për rikonstruksionin e komplet kanalit, është e nevojshme që të bëhen riparime të pjesëshme sektoriale me zëvendësim tubacioni në sifonin nr.1 në rreth 110 ml si dhe rreth 40ml në vende të ndryshme të këtij objekti.

Meqenëse këta sifone kalojnë në terrene tepër të thyer ku nuk mund të futen automatet, për transportin e materialeve në vendet e ndërhyrjeve është e nevojshme që të përdoren edhe kafshë ngarkese edhe makineri e mjete të fuqishme për cvendosjen dhe manovrimin e tubacioneve në trasenë e kanalit në zonat me pjerrësi të madhe e gjatesi mbi 150ml.

Për realizimin e këtij meremetimi është e nevojshme që për disa procese me kryesore të kryhen volume si më poshtë;

Pastrohet nga shkurre e peme në trasene e tubacionit një sipërfaqe prej rreth 150m²

Gërmim dhera për hapje kanali, zbulim tuba e themele bllokazhesh rreth 380m³

Të zëvendesohen e të riparohen tubacionet e celikut në sifone etj. për rreth 9.4 ton

Ndërtim bazamente betoni për fiksion tubacioni në terrene të pjerrëta rreth 6m³

Të vendosen sipas projektit konstruksione, detaje metalike e hekurbetoni rreth 330kg

Të eliminohen rrjedhjet në tubacionet e sifoneve me saldim pllaka celiku etj.

Për realizimin e këtij rikonstruksioni është i nevojshëm një fond prej rreth 4.5 milion lekë dhe duke e parë në aspektin social e ekonomik ky investim do të sigurojë vazhdimësinë zhvillimit normal të bizneseve agrare për fermerët e këtyre fshatrave.

HARTOI

Ing. Dhorë Nishku

Ledjan Hoxha